

		<b>ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS</b> <b>KOSOVO DOCTORS CHAMBER</b> <b>LEKARSKA KOMORA KOSOVA</b>	
Njësia:	Unit:	Nr. Prot.:	Prot. No.:
Unit:	Unit:	Prot. No.:	Prot. No.:
Jednica:	2K	Br. Prot.:	44/2018
Nr. i faqeve:	No. of pages:	Data:	Date:
02	02	17.09.2018	17.09.2018
Br. stranica:		Datum:	
		Prishtinë/a	



**ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS**  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

NR. REF. 44/2018

**PËR:**

Dr. Basri Sejdiu, Drejtor i Përgjithëshëm SHSKUK  
Drejtorët e Spitaleve Rajonale dhe të Përgjithshme në Ferizaj, Mitrovicë, Pejë, Prizren,  
Gjilan, Gjakovë dhe Vushtrri;  
Drejtorët e QKMF-ve;  
Drejtorët e Drejtorive Komunale të Shëndetësisë;  
Drejtorët / Menaxherët e Institucioneve Private dhe OJQ-ve;

**CC:** Dr. Ardita Baraku; Kryeinspektore, Inspektorati Shëndetësor;  
Dr. Naser Ramadani, Kryetar, Bordi i SHSKUK

**NGA:** Dr. Pleurat Sejdiu, Mr. Sci., Kryetar, Oda e Mjekëve të Kosovës (OMK)

**LËNDA:** Qarkore informative lidhur me detyrimin e përdorimit të faksimilave (vulave) dhe formatit unik të miratuar nga OMK-ja

**Datë:** 17 shtator 2018

Të nderuar,

Sipas Nenit 21, paragrafit 3 të Rregullores për Regjistrimin, Licencimin dhe Rilicencimin e Mjekëve është theksuar se faksimili i lëshohet mjekut të licencuar me rastin dhënies së licencës që paraqet shenjë për identifikimin profesional. Pra sipas këtij përkufizimi, faksimili paraqet nënshkrimin profesional të mjekut.

Meqenëse rëndësia e posedimit dhe përdorimit të faksimilit në kuptim të autenticitetit të mjekut dhe rëndësisë në komunikimin institucional që bartin dokumentet të cilat nga përmbajtja e tyre tregojnë gjendjen faktike lidhur me shëndetin e pacientit, implikimi i kësaj rëndësie në procedura ligjore është jetik.

Përmes kësaj shkrese, në cilësi të organizatës e cila i përfaqëson interesat profesionale dhe e detyruar që të kujdeset për integritetin dhe kredibilitetin e profesionit të mjekut, ju njoftojmë se OMK-ja ka zhvilluar procedurat e tenderimit për dhënie të kontratës për furnizim për punimin/prodhimin e autorizuar të faksimilave sipas formës së miratuar dhe përmbajtjes që është përcaktuar me Nenin 21, paragrafin 4 të Rregullores për Regjistrimin, Licencimin dhe

Rilicencimin e Mjekëve. Prandaj, të gjithë mjekët që ofrojnë shërbime shëndetësore dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të gjithë teritorin e Republikës së Kosovës, do të jenë të obliguar që të pajisen me faksimilet unike të prodhuara nën autoritetin e OMK-së. Furnizimi i tillë do të bëhet brenda periudhës gjatë muajve tetor – dhjetor 2018, ndërkaq pas datës 1 janar 2019, të gjithë mjekët që posedojnë licencë valide do të jenë të obliguar që të jenë të pajisur me faksimilin zyrtar të lëshuar nga OMK-ja.

Mjekët të cilët janë anëtarësuar deri me datë 1 korrik 2018 nuk do të kenë nevojë për të paguar taksën e faksimilit, e cila është përcaktuar me vendim të Kuvendit të OMK-së. Ndërkaq të gjithë mjekët të cilët janë anëtarësuar pas datës 1 korrik 2018 dhe ata të cilët ende nuk janë anëtarësuar, do të jenë të obliguar që krahas anëtarësimit të tyre, pagesës së taksës administrative, të paguajnë edhe taksën administrative për faksimil në shumë prej 15.00 €.

Konsiderojmë se, institucionet relevante do të kenë parasysh se lëshimi i dokumenteve dhe raporteve mjekësore pa faksimil valid do të duhet interpretuar si ushtrim i veprimtarisë mjekësore në kundërshtim të autorizimeve ligjore, gjë e cila tërheqë përgjegjësinë penale të mjekut, para se të gjithash si person zyrtar në kuptim të dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, në drejtim të ushtrimit të kundërligjshëm të veprimtarisë mjekësore, vepër kjo e sanksionuar me dispozita e Nenit 262 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Ne shpresojmë se të gjitha institucionet që u drejtohet kjo shkresë do të kenë parasysh që mjekët e punësuar në institucionet përkatëse, të jenë të informuar për këtë rregullativë dhe se çdo dokument mjekësor i lëshuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, do të jenë subjekt i ndjekjes institucionale për kundërligjshmërinë e shkaktuar përmes veprimtarisë së tyre profesionale.

Për dijenin Tuaj, OMK-ja përmes qarkorës së veçantë, kohë më parë i ka njoftuar të gjitha organet e zbatimit të ligjit, përfshirë këtu Këshillin Gjyqësor dhe atë Prokurorial, Policinë e Kosovës, Shoqatën e Kompanive të Sigurimeve dhe të gjitha institucionet të tjera relevante, se pas datës 1 janar 2019, asnjë dokument shëndetësor i cili lëshohet nën autorsinë e mjekut gjegjës pa faksimil të lëshuar nga OMK-ja do të konsiderohet si pavlefshëm.

OMK-ja në kohë të afërt do t'ju njoftojë lidhur me oraret e shpërndarjes, respektivisht pranimit-dorëzimit personal të faksimilëve nga ana e mjekëve të anëtarësuar në OMK dhe posedues të licencës valide.

Me respekt,

Prishtinë, 17 shtator 2018

Dr. Pleurat Sejdiu, Mr. Sci.

Kryetari i OMK-së

